



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 06.09.2024

Nr. 12 i vendimit
Datë 05.02.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 05.02.2026, ditën e enjte, në orën 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 34/2024 (JR), datë 06.09.2024, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 768, datë 31.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Sonjela Voskopi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi pretendimet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik, i cili kërkoi ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 768, datë 31.05.2024, dhe pas kalimit procedural, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, si dhe, pasi dëgjoi parashtrimet dhe analizoi kërkimet në bisedimet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, e cila, pas fjalës së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi pushimit e gjykimit të çështjes në Kolegj, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, dhe e bisedoi atë në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Sonjela Voskopi (referuar në vijim “subjekti i rivlerësimit” dhe/ose “subjekti”), në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016 dhe të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Korçë dhe për rrjedhojë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”). Nga këto raporte rezulton në mënyrë të përmblodhur si vijon.
 - a) ILDKPKI-ja¹, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Sonjela Voskopi”, referoi se:
 - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - nuk ka kryer fshehje;
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
 - b) DSIK² ka hartuar dhe dërguar raportin e kontrollit të figurës së subjektit. Në raportin e përcjellë nga ky institucion me shkresën e datës 20.11.2023, konfirmohet *përshtatshmëria* e subjektit për vazhdimin e detyrës. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”)³ nëpërmjet një raporti të deklasifikuar pjesërisht, në datën 13.05.2024, bëri me dije se për subjektin e rivlerësimit nuk disponohen të dhëna apo sinjalizime për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, ndërsa ka informacione/të dhëna, sipas të cilave bashkëjetuesi i saj, në cilësinë e avokatit, *mund të ketë ushtruar ndikim të paligjshëm me qëllim favorizimin e të pandehurve*. Gjithashtu, AKSIK ka informuar Komisionin se është ndarë informacion ku përmendet bashkëjetuesi i znj. Voskopi me Strukturën e Posaçme Anti-Korrupsion (në vijim “SPAK”). Referuar të njëjtës shkresë, SPAK ka informuar AKSIK se për bashkëjetuesin e subjektit ka një procedim penal në fazën e hetimeve paraprake në të cilin nuk rezulton të ketë persona të regjistruar nën hetim. Përfundimisht, AKSIK konfirmon konstatimin fillestar për *përshtatshmërinë* e subjektit në vijimin e ushtrimit të detyrës, duke shtuar edhe që i përket organeve rivlerësuese të konkludojnë “nën dritën e informacioneve që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ”.

¹ Kontrolli i deklaratës së pasurisë dërguar nga ILDKPKI-ja e shkresën e datës 27.3.2018.

² Shkresa e datës 20.11.2023 dhe shkresa e datës 13.05.2024 me raportet për kontrollin e figurës [të datës 9.05.2024].

³ Ndryshuar emri i institucionit, sipas shkresës së dërguar për njohje në Kolegj në datën 28.03.2023.

c) KLGj⁴, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë raportin për aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit:

3. Pas rivlerësimit për të tri kriteret, me vendimin nr. 768, datë 31.5.2024, me shumicë votash⁵, Komisioni vendosi të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit, pasi arriti në konkluzionet si vijon:

3.1. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, pasi përfshiu në analizë të ardhurat dhe shpenzimet e dokumentuara të anëtarëve të familjes, likuiditetet e familjes sipas gjendjeve bankare, dhuratën nga gjyshërit tek e ëma e subjektit gjatë viteve 2009 – 2010, të ardhurat e bashkëjetuesit për vitin 2015 në shumën 500.000 lekë, dhe çdo të ardhur dhe shpenzim që u evidentua gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni konstatoi një mungesë prej (-) 252.363 lekë për periudhën e rivlerësimit. Për burimin e krijimit të apartamentit me sipërfaqe 104 m² në Korçë dhe mobilimit të tij, shpjegimet e subjektit që familja e saj krijoi gjendje *cash* përgjatë periudhës 1993 – 2008, ishin bindëse. Komisioni i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare, nga e cila rezultojnë burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit. Përfundimisht, duke konstatuar se masa disiplinore e shkarkimit nuk do të ishte proporcionale, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm, nuk ka fshehur pasurinë, si dhe nuk ka zhvilluar procese gjyqësore në kushtet e konfliktit të interesit.

3.2. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, të dhënat për bashkëjetuesin e subjektit të rivlerësimit nga organet ndihmëse, Komisioni çmoi t'i vlerësojë sipas parimit të prezumimit të pafajësisë. Duke patur parasysh që çështja në Prokurorinë e Posaçme është në fazën e hetimit paraprak, emri i bashkëjetuesit të subjektit nuk është shënuar në regjistër, dhe as ka marrë cilësinë e të pandehurit apo të ketë vendim penal të formës së prerë për fajësinë e tij, Komisioni nuk gjeti veprime që e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi dhe se subjekti ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe nuk konstatoi mangësi në veprimet e saj. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e kontrollit të figurës, duke referuar nenin 110, pika 1/d⁶ të ligjit nr. 96/2016, dhe në zbatim të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

3.3. *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, pasi kontrolloi pesë dosjet e zgjedhura sipas procedurës standarde, si dhe denoncime/ankesa gjatë procesit, Komisioni konstatoi se:

⁴ Raport për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi, dërguar me shkresën e datës 02.02.2022.

⁵ Komisionerja Valbona Sanxhaktari votoi pro shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, për kriterin e kontrollit të pasurisë. Sipas saj, apartamenti në përdorim të subjektit, ngre dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e saj, të cilën e ka poseduar qysh prej fillimit dhe është sjellë si pronare de facto, duke e vendosur atë në kushtet e një deklarimi të pasaktë e të pamjaftueshëm. Sipas Komisioneres në fjalë, “kjo pasuri ka problematikat e saj sa i përket burimit të krijimit dhe pronësisë apo të drejtave reale lidhur me të”, të cilat janë deklaruar në mënyrë të pasaktë në deklaratën Vetting dhe ajo nuk ka paraqitur argumente bindëse lidhur me faktet e rezultuara gjatë hetimit, të cilat e vendosin atë në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

⁶ Kjo dispozitë nuk ekziston. Ndërsa neni 100, “Parimet e procedimit disiplinor”, pika 1/d parashikon: 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshillat, për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në këtë pjesë, udhëhiqen dhe synojnë zbatimin e përshtatshëm dhe në mënyrë të balancuar të parimeve të mëposhtme: [...] d) prezumimin e pafajësisë.

(i) Në dy çështjet që lidhen me pjesëmarrjen në proces në cilësinë e personit të tretë, të Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Korçë, pavarësisht se nuk e ka gjykuar padinë në themel subjekti i rivlerësimit nuk duhet të kryente asnjë veprim procedural dhe të hiqte dorë nga gjykimi në bazë të nenit 72, pika 3 e Kodit të Procedurës Civile, për shkak se gjykimi zhvillohej në praninë e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Korçë, e drejtuar nga bashkëjetuesi i saj.

(ii) Duke hequr dorë nga gjithë çështjet e tjera, subjekti ka treguar predispozicion për të respektuar dispozitat ligjore. Shpjegimet e subjektit ishin bindëse dhe qëndrimi i saj në këto dy çështje nuk është në asnjë nga rastet e shkeljeve disiplinore të parashikuara nga nenit 101, 102 dhe 103 të ligjit nr. 96/2016.

(iii) Në një prej dosjeve të përzgjedhura me short në KLGj, që i përket një çështjeje të përfunduar prej subjektit në vitin 2016 me vendimin “Për deklarim ikje” [dosja nr. 5], Komisioni konstatoi tejkalim të afatit të zbardhjes dhe depozitimit të vendimit në sekretari me 4 muaj e 16 ditë, në kundërshtim me afatin 5 ditor të parashikuar nga neni 113 i Kodit të Procedurës Penale. Pavarësisht nga ky konstatim, Komisioni vlerësoi se kjo mangësi nuk mund të passjellë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

(iv) Pas analizës së kryer mbi bazën e ankimit nga një denoncuese⁷, Komisioni arsyetoi se subjekti dha argumente bindëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Pavarësisht se vendimi i subjektit u prish nga Gjykata e Lartë, masa e sigurimit qëndron plotësisht. Subjekti ka interpretuar dispozitat ligjore në përputhje me rrethanat dhe pozitën juridike të palëve, e në përfundim nuk konstatoi mangësi.

(v) Për denoncimin nga I. J. E [datë 5.10.2018], pavarësisht se vendimi i subjektit ishte prishur nga Gjykata e Lartë, si i marrë në zbatim të gabuar të ligjit, Komisioni i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit dhe nuk konstatoi mangësi.

(vi) Në përfundim, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit është “e aftë” dhe ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

4. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, në datën 07.08.2024, ushtroi ankim Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa. Komisioneri Publik kërkoi që vendimi i Komisionit nr. 768, datë 31.05.2024 të ndryshohet ose të lihet në fuqi, pas një vlerësimi tërësor, dhe duke nënvizuar nevojën që provat të arrijnë nivelin e provueshmërisë për konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, përfshijnë të tri kriteret e rivlerësimit, dhe paraqiten si vijon:

4.1. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, Komisioneri Publik ka përfshirë vendimet e dhëna nga subjekti (i) për procedimin penal nr. {***}, datë 29.7.2020, që lidhet me “vlerësimin e masës së arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit personal”, për veprën penale të “ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit”, dhe (ii) për çështjen që lidhet me vendimin e subjektit të datës 29.12.2020, “për zëvendësimin e masës së sigurimit personal”, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”, si dhe informacionet që iu vunë në dispozicion Komisionit nga DSIK për bashkëjetuesin e subjektit. Sipas Komisionerit Publik, në të dyja rastet e trajtuara, duket se subjekti i rivlerësimit ka *ndryshuar vlerësimin e masës*

⁷ Znj. V. T, e cila është ankuar për subjektin në datën 26.6.2019 dhe 19.3.2021.

së arrestit dhe ka caktuar masën e sigurimit personal, por nuk ka mundësi të vlerësojë mbi situatat dhe rrethanat konkrete të rasteve. Në këto kushte, lind nevoja për verifikimin në burim të përmbajtjes së informacioneve të klasifikuara, pasi raporti pjesërisht i deklasifikuar nuk mundëson analizën dhe mbajtjen e një qëndrimi rreth këtij kriteri. Komisioneri Publik konstaton edhe që në kërkesën për informacion që Komisioni i drejtoi Prokurorisë së Posaçme, datëlindja e bashkëjetuesit të subjektit, është e pasaktë. Komisioni ka kërkuar informacion nga Prokuroria e Posaçme dhe Prokuroria e Posaçme ka kthyer përgjigje për një individ me datëlindje të ndryshme nga ai i bashkëjetuesit të subjektit.

4.2. Për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, Komisioneri Publik e përqendroi ankimin në dy aspekte, (a) atë të konfliktit të interesit së bashku me informacionet e organeve ligjzbatuese dhe (b) gjetjet në raportin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGj-ja së bashku me denoncimet nga publiku.

(a) *Për konfliktin e interesit dhe informacionet e organeve ligjzbatuese,* në dy nga çështjet objekt ankimi, me palë pjesëmarrëse Avokaturën e Shtetit, Zyra Vendore Korçë në cilësinë e personit të tretë në gjykim, në kohën kur drejtues ishte bashkëjetuesi i saj, referuar jurisprudencës së Kolegjit⁸, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar kujdesin e duhur për të vlerësuar me objektivitet mundësinë e dorëheqjes nga shqyrtimi i çështjes, për të shmangur dyshimet për paanshmërinë e saj dhe të garantimit të perceptimit të publikut se drejtësia, jo vetëm po jepej, por edhe të dukej se po jepej. Sipas Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit e ushtroi detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në dukje dhe për efekt të procesit të rivlerësimit, duhet të trajtohet brenda indikatorit të etikës dhe angazhimit, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, dhe së bashku me gjetjet e tjera, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit tërësor sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

(b) *Për gjetjet në raportin e aftësive profesionale të hartuar nga KLGj-ja dhe denoncimet nga publiku:* (i) Komisioneri Publik kërkon që mangësia e konstatuar nga KLGj-ja, që lidhet me depozitimin e vendimit në sekretari pas 4 muajsh e 16 ditësh, të vlerësohet së bashku me gjetjet e tjera në kuptim të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Gjithashtu, edhe për denoncimet për qëndrimet e përsëritura të subjektit në raport me vendimet e Gjykatës së Lartë, Komisioneri Publik kërkon që vlerësimi të kryhet sipas indikatorëve të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, dhe së bashku me gjetjet e tjera, të vlerësohet sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti do të gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve. Shpenzimet e jetesës për vitin 2007 dhe 2015, duhet të përlllogariten sipas standardit të ILDKPKI-së. Po ashtu, për mundësinë e mbulimit të shpenzimeve të mobilimit, Komisioneri Publik pretendon se subjekti nuk provoi ligjshmërinë e të ardhurave të personit të lidhur/bashkëjetuesit në vlerën 500.000 lekë nga toka bujqësore, dhe kërkon që këto të ardhura të përjashtohen nga analiza financiare. Sipas Komisionerit Publik, duke përjashtuar këto të ardhura, subjekti dhe personi i lidhur do të ishin në pamjaftueshmëri financiare për vitin 2015, në vlerën (-) 752.363 lekë. Komisioneri Publik vlerëson se pamjaftueshmëria financiare në varësi të rezultateve të hetimit të kërkuara në shkaqet e ankimit, mund të ndikojnë në vlerësimin përfundimtar të subjektit, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

⁸ Vendimet e Kolegjit (JR) nr. 15/2021 dhe (JR) nr. 53/2023.

IV. Pretendimet e palëve gjatë gjykimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

5. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, iu qëndroi kërtimeve në ankim, ndërsa potencoi nevojën e çeljes së hetimit gjyqësor dhe administrimin e informacionit nga Prokuroria e Posaçme, me gjeneralitetet e sakta të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, sikurse edhe nevojën për t’u njohur me informacionin e klasifikuar.

6. Në parashtrimet e paraqitura në Kolegji, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji: (i) rrëzimin e ankimit të Komisionerit Publik dhe (ii) lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, si një vendim i bazuar mbi një shqyrtim të drejtë, të plotë dhe në përputhje me standardet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

6.1. Sipas subjektit të rivlerësimit, në termat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me nenin 4, pika 2 e këtij ligji, në shkaqet e ngritura në ankim nga Komisioneri Publik nuk qëndron asnjë gjetje që të konsiderohet e një niveli që të passjellë konkluzionin se ajo ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për secilin nga shkaqet e ankimit, subjekti pretendon se Komisioneri Publik nuk ka parashtruar elementë të rinj provues apo argumente juridikë që të cenojnë arsyetimin dhe konkluzionet e Komisionit.

6.2. Subjekti shton edhe që vendimi i Komisionit është i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova. Për secilin kriter, subjekti parashtron si vijon.

(i) *Për kriterin e kontrollit të figurës*, shkaqet e ankimit janë të pabazuara dhe nuk mund të ndikojnë në vlerësimin tërësor. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka arritur nivel të besueshëm.

(ii) *Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*, pasi parashtroi shpjegimet për secilën çështje objekt ankimi, subjekti konkludoi se nuk ka mangësi që mund të ngrihen në nivelin e gjetjeve me ndikim në vlerësimin tërësor të çështjes. Shkaqet e ankimit, sipas subjektit, nuk janë të bazuara dhe nuk mund të shërbejnë si indikator i mungesës së etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, sipas parashikimit të nenit 75, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, e as të përbëjnë gjetje që mund të merret në konsideratë nga Kolegji në vlerësim tërësor të çështjes.

(iii) *Për kriterin e kontrollit të pasurisë*, subjekti parashtron se konstatimet e Komisionerit Publik, për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, për vitin 2008, në shumën (-) 342.681 lekë dhe në fund të vitit 2015, në shumën (-) 752.363 lekë, nuk qëndrojnë. Ajo ka vërtetuar se pasuritë dhe shpenzimet e krijuara justifikohen plotësisht me të ardhura nga burime të ligjshme. Gjithashtu, subjekti pretendon se balanca negative totale e pretenduar nga Komisioneri Publik nuk ka peshë të atillë që të cenojë besueshmërinë financiare të saj. Në respektim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo diferencë nuk përbën shkak për vendosjen e një mase disiplinore, duke qenë se përmbushet kushti i parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Në këtë kuptim, sipas saj, niveli i besueshmërisë për kontrollin e pasurisë është i plotë dhe i mbështetur në dokumentacion ligjor.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

ii. Legjitimimi i ankuesit

8. Komisioneri Publik legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe (*ratione temporis*), pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

9. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 768, datë 31.05.2024, duke qenë se është ushtruar nga Komisioneri Publik, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.

9.1. Në seancën gjyqësore publike të datës 19.01.2026, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues i Kolegjit vendosi kalimin procedural të ankuesit nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i cili u përfaqësua në gjykim nga z. Adnan Xholi, sipas tagrave të pasqyruara në autorizimin e datës 12.01.2026. Në seancën e datës 19.01.2026, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, potencoi nevojën e çeljes së hetimit gjyqësor dhe administrimin e informacionit për bashkëjetuesin e subjektit të rivlerësimit nga Prokuroria e Posaçme, me gjeneralitete të sakta, sikurse edhe nevojën për t'u njohur me informacionin e klasifikuar.

9.2. Bazuar në pikën 3 të nenit F të Aneksit të Kushtetutës dhe të neneve 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të çelë hetimin gjyqësor dhe të kërkojë nga Prokuroria e Posaçme çdo informacion që disponohet në emër të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit. Në të njëjtën kohë, në periudhën ndërmjet seancës së datës 19.01.2026 dhe seancës së radhës, caktuar në datën 04.02.2026, trupi gjykues i Kolegjit u njoh me informacionin e klasifikuar për subjektin.

9.3. Më shkresën e datës 27.01.2026, Prokuroria e Posaçme, njoftoi Kolegjin se në emër të bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit Sonjela Voskopi, nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë kallëzim apo procedim penal. Në seancën e radhës në Kolegj, më 04.02.2026, në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kërkoi nga Kolegji *lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi* që konfirmoi subjektin në detyrën e gjyqtares, duke parashtruar si vijon:

(i) *Për kriterin e kontrollit të figurës*, duke mbajtur në konsideratë përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme, informacionet e klasifikuara të aksesuara gjatë këtij procesi, dhe me konsideratë vlerën burimore e saktësinë e informacionit, gjetjet e evidentuara nuk përbëjnë mangësi që të ndikojë në vlerësimin e kriterit të figurës apo atë profesional të subjektit të rivlerësimit dhe që të justifikojë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

(ii) *Për kriterin e kontrollit të aftësive profesionale*, pasi parashtroi qëndrimin për secilën çështje, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, vlerësoi ndër të tjera se nuk kemi të bëjmë me qëndrime të përsëritura të subjektit në raport me vendimet e Gjykatës së Lartë. Çështje e analizuara, janë gjykuar me një largësi prej 8 vitesh, dhe duhet të vlerësohen në drejtim të indikatorëve të përcaktuar nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

(iii) *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, në vlerësim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, rrethanat e krijimit të apartamentit të banimit në Korçë, duhet të mbajnë në konsideratë edhe faktin se të ardhurat janë krijuar nga prindërit e subjektit, shumë vite para se ajo të ishte subjekt rivlerësimi. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, gjetjet e konstatuara në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e administruara në proces, nuk janë të një peshe që mund të ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit Sonjela Voskopi.

9.4. Pas njohjes me këtë qëndrim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se depozitoi konkluzionet e saj me shkrim, shtoi edhe se në kushtet e dakordësisë së Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me vendimin e Komisionit, Kolegji nuk ka më objekt për të shqyrtuar dhe duhet të pushojë çështjen.

B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

10. Trupi gjykues u njoh me ankimin e paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit të Komisionit që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, me parashtrimet në seancë publike të subjektit të rivlerësimit dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme si dhe me konkluzionet përfundimtare të seancës së datës 04.02.2026 nga të dy palët. Pasi mori në vlerësim sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që kërkimi përfundimtar i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke u analizuar në harmoni me rrethanat procedurale të kësaj çështje, duhet të konsiderohet se ka barazuar efektet me ato të heqjes dorë nga ankimi.

10.1. Fillimisht, trupi gjykues i Kolegjit thekson se ankimi i Komisionerit Publik, është paraqitur me kërkitime alternative, që përfshijnë ndryshimin *ose* lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, kërkitime që kushtëzoheshin me ecurinë e hetimit gjyqësor në Kolegj. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e subjektit, parimisht gjejnë përgjigje gjatë vlerësimit të çështjes në Kolegj, si organ rivlerësimi që vihet në lëvizje nëpërmjet ankimit dhe që Kushtetuta dhe ligji e kanë pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për gjykimin përfundimtar, bazuar në një proces hetimi të plotë, në analizën e saktë dhe shteruese të provave të mbledhura dhe në zbatim të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Ndërsa në kushtet kur në bisedimet përfundimtare, pas njohjes me aktet e administruar gjatë hetimit në Kolegj, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kërkoi *lënien në fuqi* të vendimit të Komisionit, nga trupi gjykues i Kolegjit, ky qëndrim u vlerësua se është i njëjtë me ushtrimin e institutit të heqjes dorë nga ankimi, e, që për pasojë, Kolegji mbetet pa *ratio* për shqyrtimin e çështjes.

10.2. Trupi gjykues vëren se kërkimi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, për lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi është një alternativë që kushtëzon vendimmarrjen e Kolegjit, cilito që të jetë konkluzioni. Në këtë mënyrë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si pala që mbart tagrat e ankuesit, duke pranuar vendimmarrjen e Komisionit, *de facto*, nuk krijon një alternativë tjetër në

mënyrë që kontrolli dhe vendimmarrja e Kolegjit mbi vendimin objekt shqyrtimi, të jenë efektive. Vendimi i Kolegjit, për t'ia nënshtruar kontrollit vendimin e Komisionit, dhe duke vendosur në konkluzion lënien në fuqi, në këtë rast, mbetet thjesht një mjet tërësisht formal, përpos edhe pa *ratio*. Interesi i ligjshëm i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, duke mbështetur në përfundim, vendimin objekt ankimi, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk mund të interpretohet në mënyrë tjetër, përveçse si një heqje dorë nga ankimi dhe një heqje e të drejtës/detyrës së Kolegjit për t'ia nënshtruar kontrollit. Vendimi i Komisionit, në rrethanat që paraqiten në këtë moment procedural, nuk mund t'i nënshtrohet një hetimi efektiv, pasi në thelb, ushtrimi procedural është tërësisht teorik, e i pamundur të ndryshojë vendimin objekt ankimi.

10.3. Kërkimi përfundimtar për lënien në fuqi të vendimit objekt ankimi, u analizua në drejtim të interesit të ligjshëm për të vijuar procesin përpara gjykatës. Mungesa e një interesi të ligjshëm nënkupton që Kolegji do të përfshihej në çështje e do t'i përgjigjej pyetjeve tërësisht *hipotetike*, zgjidhja e të cilave nuk ka mundësi të sjellë pasojë ligjore⁹. Për këtë shkak, në kuadrin mbi të cilin është ngritur dhe funksionin procesi i rivlerësimit kalimtar, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret nuk ka një objekt për të shqyrtuar e për të cilin mund të arrijë në një konkluzion, pasi interesi publik, që mbrohet nga Komisioneri Publik/Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, sipas pikës 2 të nenit C të Aneksit të Kushtetutës, ka rënë.

11. Në këto kushte, pas reflektimit të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e premisë që kërkimi përfundimtar për lënie në fuqi të vendimit, mund të barazohet nga pasojat me heqjen dorë nga ankimi prej titullarit që mban këtë të drejtë, sipas parimeve procedurale civile, të cilat normojnë edhe procesin e rivlerësimit në zbatim të pikës 6¹⁰ të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 2¹¹ të nenit 1 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Kolegji nuk ka më lëndë të shqyrtojë çështjen për të cilën është vënë në lëvizje.
12. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit, në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen me vend të deklarojë, për efekt të këtij procesi edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit. Në kuptim të sa më sipër, Kolegji, konstaton se në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, nenet 1, pika 2 dhe 44 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenit 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi nr. 768, datë 31.05.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndaj të cilit është ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në shkronjën “b” të nenit 451 dhe nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile, me shumicë votash,

⁹Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në çështjen T-19/06, *Mindo Srl kundër Komisionit Evropian*, paragrafi 90, në <https://curia.europa.eu/juris/document/document.jsf?jsessionid=0F113F2007668B7AB5B0384B1B9B572B?text=&docId=110401&pageIndex=0&doclang=EN&mode=lst&dir=&occ=first&part=1&cid=6563354>

¹⁰ Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

¹¹ Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 34/2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 768, datë 31.05.2024, për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 05.02.2026.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues së çështjes nr. 34/2024 (JR), jam kundër vendimit nr. 12, datë 05.02.2026, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi: *“Pushimin e shqyrtimit të çështjes nr. 34/2024 (JR), në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 768, datë 31.05.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi”*.
2. Unë gjyqtare në pakicë, procedurën e ndjekur nga shumica e konsideroj jo të drejtë dhe në kapërcim të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes në fjalë.
 - 2.1. Pikësëpari, ligji nr. 84/2016, përkatësisht neni 66, pika 1 e tij ka parashikuar se, pas shqyrtimit të çështjes në Kolegji, *trupi gjykues vendos lënien në fuqi të vendimit, ndryshimin e vendimit apo prishjen e vendimit të Komisionit*. Pra, vetë ligji ka përcaktuar në mënyrë shteruese vendimmarrjet e mundshme të Kolegjit. Kjo dispozitë nuk parashikon ndonjë urdhëresë për pushimin e gjykimit të çështjes.
 - 2.2. Referuar parashikimit në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 86/2016: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji”*, jo pa qëllim, ligjvënësi nuk orienton në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të aplikuara nga shumica për pushimin e shqyrtimit të çështjes, por është kujdesur të përcaktojë dispozitat e aplikueshme në këtë proces, ato që normojnë procesin administrativ. Përcaktim, i cili vjen në harmoni dhe me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, se: *“Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012, ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’*”.
 - 2.3. Neni 64, pika 4 e Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin orienton drejtpërdrejt ligji nr. 84/2016, përcakton se: *“Tërheqja e një pale nuk çon në përfundimin e procedurës administrative, në rast se organi publik vlerëson se vazhdimësia e procedurës është në interes publik ose në interesin e ligjshëm të palëve të tjera”*.
 - 2.4. Për analogji, në kushtet kur neni 179/b, pika 5, fjalia e fundit e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë përcakton se, *gjatë periudhës nëntëvjeçare, Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolegje*, gjen zbatim edhe neni 31/b, pika 2 e ligjit organik të kësaj gjykate nr. 8577, datë 10.02.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, që përcakton se: *“Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa, kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik [...]”*.
3. Pavarësisht qëndrimit të mbajtur nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në bisedimet përfundimtare, për lënien në fuqi të vendimit nr. 768, datë 31.05.2024, për subjektin e rivlerësimit Sonjela Voskopi, trupi gjykues nuk duhet ta kishte konsideruar këtë qëndrim të barazuar me efektet e heqjes dorë nga ankimi dhe të vijonte më pas me pushimin e shqyrtimit të çështjes, bazuar në dispozitat e aplikuara të Kodit të Procedurës Civile.

Në asnjë rast, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, si gjykata e vetme e këtij procesi, nuk mund të shmangë kompetencat kushtetuese dhe ligjore, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në mbrojtje të interesit publik, e për këto arsye, si gjyqtare në pakicë, çmoj se trupi gjykues duhet të vijonte me shqyrtimin

e çështjes, deri në zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare dhe, në fund të shqyrtimit, të vendoste sipas kërkesave të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi